

L I G J
Nr.8172, datë 21.12.1996

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8054, DATË 30.12.1995 “PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 1996”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese” me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8054, datë 30.12.1995 “Për buxhetin e shtetit të vitit 1996” në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

"- të ardhurat	40.070milionë lekë
- shpenzimet	70.982milionë lekë"

Neni 2

Neni 6 ndryshohet si vijon:

"Burimet për financimin e buxhetit janë në total 30.912 milionë lekë, të specifikuara si më poshtë:

- kredi e Bankës së Shqipërisë	5.100	milionë lekë
- bonot e thesarit	23.472	milionë lekë
- kredi të huaja	2.340	milionë lekë"

Neni 3

Në nenin 8 bëhet ky ndryshim:

Mbas fjalëve “për fushatat elektorale” shtohen fjalët “... si dhe shpenzimeve të natyrës emergjente për institucionet buxhetore” (detyrime të prapambetura të institucioneve buxhetore dhe pagesë TVSH-je)."

Neni 4

Çdo akt ligjor dhe nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1688, datë 30.12.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha